

VENDIM
Nr. 235, datë 20.4.2023

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE TIRANË, TË PASURISË ME NR. 1/71, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8150, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 219, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “g”, e 5, 7 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, për njësinë administrative Tiranë, të pasurisë me nr. 1/71, me vendndodhje në zonën kadastrale 8150, sipas formularit dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur në fushën e infrastrukturës vendore.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës përfundimtare të pjesshme të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të qarkut të Tiranës”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit dhe tjetërsimi i pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Fusha e perdorimit te Prones: Infrastrukturë

Aprovoi: Erion Veliaj (Kryetar)

[illegible]